



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET
E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT**

Nr. 370 Prot.
46

Tiranë, më 12.04 2021

V E N D I M
Nr. 174 datë 05.03 2021



Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë në mbledhjen e datës 05.03.2021, me pjesëmarrjen e anëtarëve:

| | |
|--------------------|----------|
| Zj. Gentiana Sula | Kryetare |
| Z. Altin Hoxha | Anëtar |
| Z. Marenglen Kasmi | Anëtar |

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT:

Miratimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit dhe Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR)


BAZA LIGJORE:

Në mbështetje të Ligjit nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar, Rregullores “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit”, e miratuar me Vendimin nr. 21, datë 09.05.2017 të Autoritetit, e ndryshuar, ligji nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, pasi shqyrtoi projekt-marrëveshjen e bashkëpunimit ndërmjet Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH) dhe Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR).

V Ë R E N

Ligji nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë” përcakton se, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, si institucion i pavarur, është përgjegjës për zbatimin e ligjit, lidhur me mbledhjen, administrimin, përpunimin, përdorimin e dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit dhe informimin në lidhje me to të subjekteve të përcaktuara në këtë ligj.



Neni 7 i ligjit nr. 45/2015 parashikon se, Autoriteti e ka selinë në Tiranë dhe financohet nga Buxheti i Shtetit dhe burime të tjera të ligjshme. Autoriteti organizohet dhe funksionon sipas rregullave të përcaktuara në këtë ligj dhe në rregulloren e funksionimit, që miratohet prej tij dhe kryen funksionet e tij, të përcaktuara në këtë ligj, në mënyrë kolegjiale. Autoriteti ka pavarësi të plotë në vendimmarrje për ushtrimin e funksioneve të veta, që burojnë nga ky ligj apo aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.

Autoriteti, me Vendimin nr. 21, datë 09.05.2017, ka miratuar Rregulloren “Për Organizimin dhe funksionimin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit”, ku në nenin 17 të tij parashikohet shprehimisht se: “*AIDSSH-ja, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, ka të drejtë të marrë nga autoritetet publike të gjithë ndihmën, informacionin, si dhe të dhënat e nevojshme për ushtrimin e funksioneve të tij, në përputhje me Ligjin për Informimin për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit.*

1. *AIDSSH-ja bashkëpunon me organizata të huaja, rajonale dhe ndërkombëtare që synojnë mbështetjen e procesit të transparencës mbi të kaluarën komuniste dhe viktimat e diktaturës.*
2. *AIDSSH-ja bashkëpunon me konsulentë vendas apo të huaj, institucione publike, organizata partnere, vendase apo të huaja, për përmirësimin dhe modernizimin e veprimtarisë së tij, si dhe për organizimin dhe zbatimin e projekteve të ndryshme.*
3. *Për qëllime të informimit të publikut dhe përfshirjes së grupeve të interesit në procese konsultuese, AIDSSH-ja bashkëpunon me institucione, organizata të huaja, ndërkombëtare apo vendase, me grupet e interesit, shoqërinë civile dhe median.*
4. *AIDSSH-ja gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj, bashkëpunon dhe bashkërendon punën me institucionet publike vendas dhe të huaj si dhe nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi.*

Gjithashtu duke u bazuar në ligjin nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe Statuti i ASA, AIDSSH dhe ASA në mirëkuptim ndërmjet tyre kanë vendosur të lidhin një marrëveshje bashkëpunimi.

a) Marrëveshja e Bashkëpunimit ndërmjet Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit dhe Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Mbështetur në nevojat institucioneve për të bashkëpunuar me njëri tjetrin, në pikat e përbashkëta që i lidhin objektet e veprimtarisë së tyre të lindi nevoja dhe u krijuan mundësitë për lidhjen e një Marrëveshjeje Bashkëpunimi ndërmjet Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit dhe Ministrisë së Arsimit, Rinisë dhe Sporteve, Marrëveshje e cila do të ketë për objekt institucionalizimin e marrëdhënieve për bashkëpunimin e ndërsjellë të palëve, në kuadër të zbatimit të politikave arsimore dhe të formimit historik, ku përfshihen ato për periudhën gjysmëshekullore të regjimit komunist në vend.

Gjithashtu sfera e bashkëpunimit ndërinstitutional do të jetë do të përfshijë këto të drejta dhe detyrime të palëve sipas fushave të kompetences dhe misionëve që mbulojnë si më poshtë:

1. AIDSSH merr përsipër të krijojë kushtet e nevojshme për t’u bërë qendër e vizitueshme studimore për nxënësit dhe studentët, në mjediset që mund të jenë në interesin e tyre dhe të vëre në dispozicion të tyre:
 - Arkivin e Autoritetit;
 - Sallën e leximit, bibliotekën, botimet e institucionit;
 - Ekspozitat tematike për të shkuarën komuniste;



- Zhvillimin e projekteve studimore të së shkuarës, me mjediset dhe me burimet e AIDSSH-së dhe partnerëve;
 - Të vërë në dispozicion një hartë të vendeve të vuajtjes së dënimit dhe ekzekutimit, për t'u përdorur nga të interesuarit.
2. AIDSSH në vijim të punës së bërë për çështjet dhe personalitetet historike të zbardhura deri më sot, me dokumentacion dhe studime, do të mbështesë organizimin e vizitave shkollore, të inkurajuara dhe sugjeruara nga MASR, të cilat mund të jenë pjesë e programit vjetor, në:
- a. Muzeun e Shkencave të Natyrës “Sabiha Kasimati” në Tiranë; (ku AIDSSH ka kontribuar me këndin e kujtesës dhe sugjerimin për emrin);
 - b. Në vendin e ekzekutimit të 22 intelektualëve të “bombës” në legatën sovjetike, në Mënik, Pezë-Helmës, Tiranë; (ku AIDSSH ka zbardhur dosjen, nderuar persona dhe propozuar emrin e rrugës “26 shkurti”);
 - c. Kampin e Punës së Detyruar në Tepelenë; (ku AIDSSH ka zhvilluar punë kërkimore në arkiva dhe bashkëpunuar me institucione, pushtet vendor dhe organizata);
 - d. Burgun e Spaçit dhe të Burrelit; (për të cilët AIDSSH ka deklasifikuar dosje dhe kontribuar në çështje të të drejtave të njeriut të lidhura me to).
 - e. dhe vende të tjera të kujtesës.
3. AIDSSH dhe MASR marrin përsipër të bashkëpunojnë në fushën e zhvillimit të programeve të përbashkëta për:
- mësuesit e historisë;
 - tekstshkruesit e historisë dhe të programeve shkollore;
 - programshkruesit e lëndëve shkollore: histori, letërsi, gjuhësi, biologji, kimi, qytetari, gjeografi, etj.
4. Organizimin e aktiviteteve të përbashkëta që kanë në fokus të tyre krimet e komunizmit në Shqipëri dhe periudhën që ka funksionuar ish-Sigurimit i Shtetit, me qëllim njohjen dhe edukimin e nxënësve dhe studentëve me historinë e tij, si dhe zbatimin e vendimit të ministrave të Edukimit (Krakovi 2000) për caktimin në shkolla të një dite përkujtimore, si ditën përkujtimore për viktimat e regjimeve totalitare naziste dhe komuniste 23 Gushtin.
5. Të marrin pjesë në takime të organizuara nga secila palë, për çështje që janë objekt i kësaj marrëveshjeje.
6. Të bëjnë të disponueshëm kundrejt kërkesave, dokumente dhe materiale arkivore që i përkasin periudhës së komunizmit me fokus veprimtarinë e sigurimit të shtetit dhe që i nevojiten secilës palë në funksion të veprimtarisë së punës përkatëse në përputhje me legjislacionin në fuqi për arkivat;
7. Të bashkërendojnë punën për edukimin e nxënësve dhe studentëve nëpërmjet garantimit të mundësive për shqyrtimin e dokumenteve të organeve të diktaturës komuniste, duke përfshirë dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të asaj periudhe. Nxënësit mund të realizojnë projekte me qëllim jo vetëm njohjen e këtyre regjimeve, por nëpërmjet punës kërkimore ata fokusohen në pasojat që i sollën njerëzimit vendosja e këtyre regjimeve dhe në masat që duhet ndërmarrë shoqëria sot për të parandaluar përsëritjen e këtyre ngjarjeve shkatërrimtare, si kriza e thellë ekonomike, lufta e klasave, diktatura e proletariatit, politika e vetëizolimit, dhunimet masive të të drejtave të njeriut dhe të vlerave themelore të tij.



8. Të organizojnë, hapin ose shkëmbejnë ekspozita që kanë si bazë pasurinë dokumentare apo kulturore në fushat respektive që dy institucionet mbulojnë sipas ligjit.

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi do të përcaktojë rregullat e bashkëpunimit, ndërmjet MASR dhe AIDSSH në kuadër të zbatimit të politikave të përbashkëta mbështetëse, ku përfshihet periudha e komunizmit, në vitet '44-'91, bashkëpunimin në fushën e projekteve të përbashkëta me fokus njohjen dhe përkujtimin e vlerave të brezave të rinj, nëpërmjet studimit, përfshirjes dhe pjesëmarrjes në vende të kujtesës për ngjarje e vende që dëshmojnë histori dhe realitete të 1944-1991, nga krimet e komunizmit, të funksionet e ish-Sigurimit të Shtetit në Shqipëri; bashkëpunimi në fushën e zhvillimit të programeve të përbashkëta për mësuesit e historisë, tekst shkruarë të historisë dhe të kurrikulave shkollore me dokumentacionin që administron AIDSSH

Sa më sipër, vlerësojmë se, Marrëveshja ndërmjet Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit dhe Ministrisë së Arsimit, Rinisë dhe Sporteve, është e mbështetur në ligj dhe në Rregulloren e Brendshme të Institucionit.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në ligjin nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe Rregulloren e Brendshme të Institucionit “Për Organizimin dhe funksionimin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit”, të ndryshuar, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit,

V E N D O S I

1. Miratimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH) dhe Ministrisë së Arsimit, Rinisë dhe Sporteve MASR;
2. Dërgimin e kësaj Marrëveshjeje për vazhdimin e procedurave pranë Ministrisë së Arsimit, Rinisë dhe Sporteve MASR.
3. Ngarkohet Sekretariati Teknik për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



ANËTAR

Altin Hoxha

ANËTAR

Dr. Marenglen Kasmi